

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

FLETUDHËZIM: INFORMATA PËR PËRDORUESIN

Enap®-HL 10 mg/12,5 mg tableta Enalapril maleat/hidroklorotiazid

Lexojeni këtë fletudhëzim të tërin me kujdes para se të filloni ta merrni këtë bar.

- Ruajeni këtë fletudhëzim. Mund t'ju duhet ta lexoni përsëri.
- Nëse keni pyetje të tjera, pyeteni mjekun ose farmacistin tuaj.
- Ky bar është përshkruar për ju. Mos ua jepni ate të tjerëve. Mund t'u bëjë dëm atyre edhe nëse simptomat i kanë të njëjta me tuajat.
- Nëse ndonjë nga efektet anësore përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi tregojini mjekut ose farmacistit tuaj.

Në këtë fletudhëzim:

1. Çka është Enap-HL dhe për se përdoret
2. Para se të merrni Enap-HL
3. Si të merrni Enap-HL
4. Efektet e mundshme anësore
5. Si ta ruani Enap-HL
6. Informata shtesë

1. ÇKA ËSHTË ENAP-HL DHE PËR SE PËRDORET

Enap-HL është medikament i cili përdoret për uljen e tensionit të gjakut. Përmban substanca aktive të enalaprilit dhe hidroklorotiazidit.

Enalapril i përket grupit të barnave të njohur si frenues (ACE) të enzimës konvertuese të angiotenzinës, i cili vepron me anë të zgjerimit të enëve të gjakut, gjë e cila ul tensionin e gjakut dhe rrit furnizimin me gjak dhe oksigjen të muskujve të zemrës dhe organeve të tjera. Hidroklortiazidi i përket grupit të barnave që rrit largimin e urinës (diuretikët) dhe në këtë mënyrë ulë tensionin e gjakut. Aktiviteti antihipertensiv i kombinimit të enalaprilit dhe hidroklorotiazidit është më i fuqishëm se aktiviteti që ato kanë kur përdoren të ndarë.

Mjeku ju ka përshkruar Enap-HL për shkak se keni hipertension ose tension të lartë të gjakut.

2. PARA SE TË MERRNI ENAP-HL

Mos merrni Enap-HL:

- nëse jeni alergjik ndaj enalapril maleatit, hidroklorotiazidit ose ndaj ndonjë prej përbërësve të tjerë të Enap-HL;
- nëse më parë keni pasur reaksion mbindjeshmërie me ënjtje të papritur të buzëve dhe fytyrës, qafës, ndoshta edhe të duarve dhe këmbëve ose ngjirje të zërit (angioedemë), pas marrjes së barnave të ngjajshme;
- nëse keni angioedemë të trashëguar ose angioedemë të një shkakut tjetër, të panjohur;
- nëse jeni të mbindjeshëm në sulfonamide (pyesni mjekun tuaj nëse nuk jeni të sigurtë se çka janë sulfonamidet);
- nëse keni dëmtim të rëndë të veshkëve ose mëlçisë;
- nëse keni ngushtim të arterieve që furnizojnë veshkat me gjak;
- nëse keni mbajtje të urinës;
- nëse jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë (është gjithashtu më mirë të mos përdoret Enap-HL edhe në fillim – lexoni më poshtë te pjesa Shtatzënia dhe ushqyerja me gjë).

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- nëse keni diabet ose funksion të dëmtuar të veshkëve dhe merrni medikament për uljen e tensionit të gjakut i cili përmban aliskiren.
- nëse keni marrë ose nëse aktualisht merrni sakubitril/valsartan, medikament i cili përdoret për trajtimin e llojit afatgjatë (kronik) të insuficiencës së zemrës të rriturit, si rrezik nga angioedema (enjtje e shpejtë nën lëkurë në rajonin siç është fyti), është i rritur.

Tregoni kujdes të veçantë me Enap-HL

Bisedoni me mjekun ose farmacistin tuaj para se të merrni Enap-HL.

Posaçërisht bëni kujdes me Enap-HL:

- nëse keni tension të ulët të gjakut dhe kripës dhe disbalans të lëngjeve;
- nëse jeni duke u trajtuar për sëmundje të veshkave,
- nëse jeni duke u trajtuar për hemodializë,
- nëse kohët e fundit keni bërë transplantim të veshkëve;
- nëse jeni duke u trajtuar për diabet;
- nëse jeni duke u trajtuar për sëmundje të mëlçisë;
- nëse jeni duke u trajtuar për giht;
- nëse shëroheni nga sëmundje e rëndë e indit lidhor (lupus sistemik eritematoz);
- nëse keni sëmundjen e valvulave të zemrës apo sëmundje tjera të zemrës;
- nëse jeni të mbindjeshëm në barnat nga grupi i sulfonamideve;
- nëse jeni duke marrë diuretikë,
- nëse keni vjellje ose keni diarree (barkqitje);
- nëse së fundi keni vuajtur nga vjellja dhe diarrea (barkqitja) e madhe;
- nëse keni njohuri se mund të keni nivele të larta të acidit urik në gjakun tuaj;
- nëse mjeku ju ka thënë se keni jotolerancë në disa sheqerna;
- nëse merrni litium i cili përdoret për trajtimin e disa sëmundjeve mendore;
- nëse keni pasur kancer të lëkurës ose nëse gjatë trajtimit ju paraqiten papritur lezionet e lëkurës. Trajtimi me hidroklorotiazid, posaçërisht me aplikim afatgjatë në doza të larta, mund të shtojë rrezikun nga disa lloje të kancerit të lëkurës dhe kancer të zgavrës së gojës (kancer jomelanom i lëkurës). Mbron lëkurën nga ekspozimi ndaj diellit dhe rrezeve UV derisa merrni Enap-HL.
- nëse keni pasur probleme me frymëmarrjen ose me mushkëri (duke përfshirë inflamacionin ose lëngjet në mushkëri) pas marrjes së hidroklorotiazidit në të kaluarën. Nëse keni ndonjë gulçim të rëndë ose vështirësi në frymëmarrje pas marrjes së Enap-HL, kërkoni kujdes mjekësor menjëherë.
- nëse keni rënie të të pamurit ose dhimbje të syve. Këto mund të jenë simptoma të akumulimit të lëngjeve në shtresën vaskulare të syrit (efuzioni koroidal) ose ngritjes së shtypjes në syrin tuaj dhe mund të ndodhin brenda disa orëve deri në disa javë pas marrjes së Enap-HL. Kjo mund të çojë në humbje të përhershme të shikimit, nëse nuk trajtohet. Nëse më parë keni pasur alergji në penicilinë ose sulfonamid, mund të jeni në rrezik më të lartë për ta zhvilluar këtë.
- nëse merrni ndonjë nga medikamentet në vazhdim, rritet rreziku nga angioedema:
 - racecadotril, përdoret për trajtimin e diarresë;
 - medikamente të cilat përdoren për parandalimin e mospranimit të organeve të transplantuara dhe për kancer i cili i përket klasit të mTOR inhibitorëve (p.sh. temsirolimus, sirolimus, everolimus);
 - vildagliptin, medikament i cili përdoret për trajtimin e diabetit.
- nëse merrni disa nga këto medikamente të cilat përdoren për trajtimin e tensionit të lartë të gjakut:
 - blokator të receptorëve të angiotenzinës II (ARB) (gjithashtu të njohura si sartane – për shembull valsartan, telmisartan, irbesartan), posaçërisht nëse keni problem me veshkë që janë të lidhura me diabetin.
 - aliskiren.

Mjeku juaj mund të kontrollojë funksionin e veshkëve, tensionin e gjakut dhe sasinë e elektroliteve (p.sh. kalium) në gjak në intervale të rregullta. Shihni edhe informacionet me titull "Mos merrni Enap-HL".

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Para se ti nënshtroheni ndonjë operacioni apo anestezioni (edhe te dentisti) tregoni mjekut se jeni duke marrë kombinim të enalaprilit dhe hidroklorotiazidit.

Kur mjeku juaj planifikon

- trajtimin me hemodializë;
- largimin e kolesterolit nga gjaku (aferezë);
- trajtim desensibilizues (trajtim për të zvogëluar efektet e alergjisë në blea ose grejza);
- analiza për të kontrolluar funksionin e gjendrave të tiroides (gjëndrat që ndodhen në fytyrë tuaj të cilat kontrollojnë nivelin e kalciumit në gjak);

Duhet të njoftoni mjekun i cili po ju trajton, se jeni duke marrë kombinim të enalaprilit dhe hidroklorotiazidit.

Nëse keni angina pectoris dhe gjendja juaj përkeqësohet gjatë marrjes së kombinimit të enalaprilit dhe hidroklorotiazidit, duhet ti tregoni mjekut.

Duhet ti tregoni mjekut tuaj nëse mendoni se jeni shtatzënë (ose planifikoni të mbeteni shtatzënë). Enap-HL nuk rekomandohet në fillim të shtatzënisë, gjithashtu nuk duhet të merret nëse jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë, për shkakun se mund të shkaktojë dëmtime serioze në foshnjën tuaj nëse përdoret në atë fazë (lexoni pjesën e Shtatzënia dhe ushqyerja me gjë).

Fëmijet dhe adoleshentët

Ky medikament nuk i jepet fëmijëve pasi që nuk ekzistojnë të dhëna mbi efikasitetin dhe tolerancën e medikamentit te fëmijët.

Marrja e barnave tjera

Ju lutem tregojini mjekut ose farmacistit nëse jeni duke marrë ose keni marrë barna të tjera kohëve të fundit, duke përfshirë barnat që merren pa recetën e mjekut.

Kjo posaçërisht referohet për:

- medikamente tjera për tension të lartë të gjakut;
- suplementet e kaliumit (duke përfshirë substituentët e kripës), diuretikët të cilët ruajnë kaliumin (p.sh. spironolakton, amiodaron) dhe medikamentet tjera të cilat mund të rritin sasinë e kaliumit në gjak (p.sh. trimetoprim dhe ko trimoksazol, gjithashtu të njohur si trimetoprim/sulfametoksazol, për infeksione të shkaktuara me bakterie; ciklosporina, medikament imunosupresiv që përdoret për parandalimin e përjashtimit të organeve të transplantuara; dhe heparin, medikament i cili përdoret për hollimin e gjakut që të parandalojë koagulimin e gjakut);
- medikamente për largimin e dhimbjeve dhe medikamentet antiinflatore (medikamentet antiinflatore josteroidë, p.sh. ibuprofen, diklofenak);
- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e depresionit (p.sh. litium, antidepressivët triciklik, antipsikotikët);
- medikamentet të cilat rritin sasinë e urinës (diuretikët);
- medikamentet të cilat përdoren për zvogëlimin e kolesterolit në gjak (p.sh. rrëshira, kolestiramina dhe kolestipoli);
- medikamentet të cilat përdoren për ndalimin e rritjes së tumorëve (citostatikët, p.sh. ciklofosamid, metotreksat);
- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e gjendjeve të caktuara siç është reuma, artriti, gjendjet alergjike, astma ose çrregullime të caktuara të gjakut (kortikosteroidet);
- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e ritmit të çrregullt të zemrës (procainamid, amiodaron ose sotalol);
- medikamentet të cilat përdoren për trajtimin e insuficiencës së zemrës (digitalis);
- medikamentet të cilat përdoren kundër kollitjes dhe ftohjes (simptomimetikët) ose noradrenalina dhe adrenalina, që përdoren për trajtimin e tensionit të ulët të gjakut, shokut,

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- insuficiencës së zemrës, astmës ose alergjisë; nëse përdoren njëkohësisht me Enap-HL, këto medikamente mund të mbajnë tensionin e gjakut të lartë;
- medikamentet antidiabetike, siç është insulina; Enap-HL mund të shkaktojë rënie të nivelit të sheqerit në gjak edhe më shumë nëse merret njëkohësisht me antidiabetikë;
 - relaksues të muskujve (p.sh. tubokurarin që përdoret në anestezion);
 - gold injekcion për trajtimin e artritis (natrium aurotiomalat);
 - medikamentet të cilat më së shpeshti përdoren për parandalimin e mospranimit të transplantimit të organeve (sirolimus, everolimus dhe medikamentet tjera të cilat i takojnë klasit të mTOR inhibitorëve). Shihni seksionin "Tregoni kujdes të veçantë me Enap-HL".

Mjeku juaj ndoshta duhet të ndryshojë dozën tuaj dhe/ose të marrë masa të tjera të sigurisë:

- nëse merrni blokatorë të receptorëve AT II (ARB) ose aliskiren (shih informacionin me titull "Mos merrni Enap-HL" dhe "Tregoni kujdes të veçantë me Enap-HL").

Marrja e Enap-HL me ushqim, pije dhe alkool

Ju mund të merrni barin gjatë ose pas ushqimit me pak ujë.

Mos pini alkool gjatë trajtimit sepse mund të shkaktojë marramendje e posaçërisht gjatë ngritjes në këmbë. Nëse kjo ndodh duhet menjëherë ta ndërpreni alkoolin.

Shtatzënia dhe gjdhënia

Kërkojini këshillë mjekut ose farmacistit para përdorimit të barnave.

Shtatzënia

Duhet ti tregoni mjekut nëse jeni (ose mund të mbeteni) shtatzënë. Mjeku do të ju këshillojë të ndërpreni marrjen e Enap-HL para se të mbeteni shtatzënë apo sa të kuptoni se jeni shtatzënë dhe do të ju këshillojë të merrni bar tjetër në vend të Enap-HL.

Enap-HL nuk rekomandohet në fillim të shtatzënisë, gjithashtu nuk duhet të merret nëse jeni më shumë se 3 muaj shtatzënë, për shkakun se mund të shkaktojë dëmtime serioze në foshnjën tuaj nëse përdoren në atë fazë.

Ushqyerja me gji

Tregoni mjekut tuaj nëse jeni duke ushqyer me gji foshnjën ose do të filloni ushqyerjen me gji.

Enap-HL nuk i rekomandohet nënave të cilat ushqejnë fëmijët me gji.

Ngasja dhe përdorimi i makinerive

Në pacientë të veçantë, Enap-HL mund të shkaktojë hipotension dhe marrje mendsh sidomos në fillim të trajtimit, duke dëmtuar kështu indirekt dhe përkohësisht aftësinë për të ngarë makina ose për të përdorur makineri.

Informata të rëndësishme për disa nga përbërësit e Enap-HL

Enap-HL përmban laktozë dhe natrium.

Nëse mjeku ju ka thënë se keni intolerancë ndaj disa sheqernave, njoftoni mjekun para se të merrni këtë medikament.

Ky medikament përmban më pak se 1 mmol natrium (23 mg) për dozim, që në parim do të thotë se është 'pa natrium'.

3. SI TË MERRET ENAP-HL

Gjithmonë merrni Enap-HL saktësisht siç ju ka udhëzuar mjeku. Duhet të konsultoheni me mjekun ose farmacistin nëse nuk jeni të sigurt.

Dozimi:

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

Doza e zakonshme është një tabletë një herë në ditë.

Nëse nevojitet, mjeku mund të rritë dozën në dy tableta një herë në ditë.

Nëse merrni diuretikë të tjerë (tableta të ujit), këshillohuni me mjekun tuaj para fillimit të marrjes së këtij medikamenti.

Duhet të ndërpritet trajtimi me diuretik dy deri në tre ditë para fillimit të trajtimit me Enap-HL.

Mënyra e përdorimit:

Merreni tërë tabletën gjatë ose pas ushqimit me pak ujë. Tabletën duhet ta merrni rregullisht më së miri në mëngjes dhe në të njëjtën kohë çdo ditë.

Nëse keni përshtypjen se Enap-HL ka efekt të fort ose të dobët, tregoni mjekut tuaj.

Nëse merrni Enap-HL më shumë se ç'duhet

Shenjat më të shpeshta të mbidozimit janë mundim, ritëm i shpejtë i zemrës, marrje mendsh dhe të fikët për shkak të uljes shumë të madhe të tensionit të gjakut (hipotension).

Nëse keni marrë më shumë tableta gabimisht kontaktoni menjëherë mjekun.

Nëse harroni të merrni Enap-HL

Mos merrni dozë të dyfishtë për të kompenzuar dozën e harruar.

Nëse keni harruar të merrni barin, merreni dozën tjetër si zakonisht, por sigurohuni ti tregoni mjekut tuaj.

Nëse e ndërprisni marrjen e Enap-HL

Pas ndërprerjes së trajtimit, tensioni i gjakut mund të rritet përsëri, gjë që rrit rrezikun e komplikimeve të shkaktuara nga tensioni i lartë i gjakut, posaçërisht në zemër, tru dhe veshka.

Në rast se keni pyetje të mëtejme lidhur me përdorimin e këtij produkti, drejtohuni mjekut ose farmacistit.

4. EFEKTET ANËSORE TË MUNDSHME

Sikurse të gjitha barnat, Enap-HL mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo të gjithë paraqiten ato.

Duhet të ndërpreni marrjen e barit dhe të kërkon ndihmë mjekësore menjëherë nëse fillon kruarja, frymëmarrja e shkurtuar ose fishkëlluese, të zhvillohen skuqe të rënda të duarve, gojës, fytit, fytyrës dhe syve.

Është shumë e rëndësishme që të ndërpreni marrjen e barit menjëherë dhe shkoni te mjeku nëse keni marramendje (e posaçërisht në fillim të trajtimit ose gjatë rritjes së dozës ose gjatë ngritjes në këmbë).

Shumë shpesh: mund të ndikojë në më shumë se 1 në 10 persona

- shikim i mjegulluar
- marramendje
- kollitje
- ndjenjë e sëmundjes (mundim)
- dobësi (astenia)

Shpesh: mund të ndikojë te 1 në 10 persona

- kalium i ulët në gjak, rritje e nivelit të kolesterolit, triglicerideve dhe acidit të urinës në gjak
- kokëdhimbje, depresion, marramendje (sinkopa), ndryshim i shijes
- tension i ulët i gjakut në pozitë në këmbë, dobësi, punë e çrregullt e zemrës, dhimbje në gjoks (angina pectoris), punë e përsheptuar e zemrës
- frymëmarrje e vështirësuar (dispnea)

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- diarrea, dhimbje në bark
- puçrra
- spazëm të muskujve
- dhimbje në gjoks, lodhje
- nivel i rritur i kaliumit në gjak, nivel i rritur i kreatininës në serum

Jo të shpeshta: mund të ndikojë te 1 në 100 persona

- anemi
- skuqje, rrahje e përshpejtuar e zemrës (palpitacione), sulm në zemër dhe sulm në tru, sigurisht për shkak të zvogëlimit të tepruar të tensionit të gjakut te pacientët me rrezik të lartë nga komplikimet kardiovaskulare
- tringëllima në veshë (tinitus)
- zbrazje e hundës (rinoreja), dhimbje në fyt dhe ngjirje e zërit, astma
- obstrukcion i zorrëve (ileus), ndezje e pankreasit (pankreatitis), vjellje, çrregjullime të traktit digjestiv (dispepsia), akumulim në zorrë (fryrje), konstipacion, humbje e apetitit (anoreksi), stomak i irituar, tharje e gojës, ulkus
- dëmtim i funksionit të veshkëve, dështim i veshkëve, protein në urinë (proteinuria)
- kruarje, djersitje, humbje e flokëve
- dhimbje në nyje (artralgjia)
- ndjenjë e lëkundjes (e shkaktuar nga niveli i ulët i sheqerit në gjak), nivel i ulët i magnezit, dhimbje e kockave
- impotencë
- shqetësim, ethe
- konfuzion, zvogëlim i libidos, pagjumësi dhe nervozë, ndjenjë e lëkundjes (Vertigo), ndjenjë e shpimit me gjilpërë në duar dhe në këmbë (parestesia)
- rritje e ureas në serum, zvogëlim i nivelit të natriumit në gjak

Rrallë: mund të ndikojë te 1 në 1.000 persona

- ndryshime në gjak (neutropenia, hipohemoglobinemia, hematokrit i zvogëluar, trombocitopenia, leukopenia)
- rritje e nivelit të glukozës në gjak
- ëndërra të çuditshme, probleme me gjum, dëmtim i lëvizjeve (pareza)
- gjëndrra të ënjtura, sëmundje autoimmune, qarkullim i ulët i gjakut në gishta dhe në thembrat, që shkakton skuqje dhe dhembje (sindroma Raynaud's)
- lëng në mushkëri, rrjedhje ose ndezje e hundës, pneumoni eozinofile (shenjat mund të jenë kollitja, temperatura e lartë dhe frymëmarrja e përshpejtuar)
- enjtje ose ulkuse në gojë, infeksione ose dhimbje dhe enjtje e gjuhës
- insuficiencë e mëlçisë ose hepatit, që mund të shkaktojë ndryshime të ngjyrës së lëkurës tuaj në të verdhë (verdhëza)
- skuqje e tepruar e lëkurës tuaj, puçrra dhe ndezje e lëkurës, posaçërisht në duar dhe në këmbë dhe rreth gojës, me ethe (sindroma Stevens-Johnson), rrjepje e lëkurës në muskujt e këmbëve
- probleme me veshkë, siç është dhimbja në pjesën e shpinës dhe vëllim i zvogëluar i urinës
- rritje e gjinjve të meshkujt
- rritje e enzimeve të mëlçisë ose bilirubinës në gjak

Shumë rrallë: mund të ndikojë te 1 në 10.000 persona

- enjtje e zorrëve (angioedema e zorrëve); shenjat mund të përfshijnë dhimbje në stomak, mundim dhe vjellje
- nivel i rritur i kalciumit në gjak
- distresi respirator akut (shenjat përfshijnë gulçimin e rëndë, ethet, plogështinë dhe konfuzionin).

Nuk është e njohur: frekuenca nuk mund të vlerësohet në bazë të të dhënave të disponueshme

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

- kanceri i lëkurës dhe zgavrës së gojës (kancer jomelanom i lëkurës)
- sindroma e sekretimit të papërshtatshëm të hormonit antidiuretik (SIADH) (i cili shkakton nivel të ulët të natriumit në gjak).
- të pamurit e dobësuar ose dhimbjet në sytë tuaj për shkak të shtypjes së lartë (shenjat e mundshme të akumulimit të lëngjeve në shtresën vaskulare të syrit (efuzioni koroidal) ose glaukoma akute me mbyllje të këndit).

Gjithashtu, është paraqitur një kompleks simptomash që mund të përfshijë disa ose të gjitha shenjat në vijim: ethe, ndezje të membranës e cila rrethon disa organe të brendshme (membranë seroze), ndezje e enëve të gjakut, dhimbje/ndezje e muskujve ose nyjeve ndryshime në disa parametra laboratorike (antitruapat antinukleare pozitive (ANA), sedimentacion i rritur në gjak, eozinofile dhe leukocitoza).

Nëse ndonjë efekt anësor përkeqësohet, ose nëse vëreni ndonjë efekt anësor që nuk figuron në këtë fletudhëzim, ju lutemi njoftojeni mjekun ose farmacistin tuaj.

Raportimi i efekteve anësore

Nëse keni çfarëdo efekteve anësore, bisedoni me mjekun tuaj. Kjo përfshin të gjitha efektet e mundshme të padëshirueshme të cilat nuk janë dhënë në këtë udhëzim. Gjithashtu mund të paraqitni efekteve anësore drejtëpërsëdrejti përmes sistemit nacional të raportimit.

5. SI TË RUHET ENAP-HL

Mbajeni larg syve dhe duarve të fëmijëve.

Mos e përdorni Enap-HL pas datës së skadimit e cila është e shënuar në karton pas EXP. Data e skadimit i referohet ditës së fundit të atij muaji.

Ruajeni në paketim original të mbrojtur nga lagështia.

Barnat nuk duhet të hidhen nëpërmjet kanalizimit ose mbeturinave të shtëpisë. Pyeteni farmacistin se si t'i hidhni barnat që nuk ju duhen më. Këto masa do të ndihmojnë për ta mbrojtur mjedisin.

6. INFORMATA SHITESË

Çka përmban Enap-HL

- Substancat aktive janë: enalapril maleat dhe hidroklorotiazid.
1 tabletë përmban 10 mg enalapril maleat, që është ekuivalent me 7,64 mg enalapril dhe 12,5 mg hidroklorotiazid.
- Përbërësit e tjerë janë: monohidrat laktoze, amidon misri, amidon i prexhelatinizuar, talk (E553b), natrium hidrogjen karbonat, stearat magnezi (E470b).
- Shihni seksionin 2 "Enap-HL përmban laktozë dhe natrium".

Si duket Enap-HL dhe përbërja e paketimit

Enap-HL tabletat janë të bardha, të rumbullakëta, të rrafshta, të shënuara në njërën anë. Viza ndarëse nuk është për qëllim të ndarjes së tabletës.

Enap-HL gjenden në kuti me nga 20 (2 x 10) tableta në blister paketim.

Mbajtësi i Autorizimit për Marketing dhe Prodhuesi

KRKA, d.d., Novo mesto, Šmarješka cesta 6, 8501 Novo mesto, Slloveni

1.3.1	Enalapril/Hydrochlorothiazide
SPC, Labeling and Package Leaflet	KO-Kosovo

tel: +386 7 331 28 84,
fax:+386 7 332 27 42
www.krka.si

Mënyra e dhënies së barit
Bari jepet me recetë të mjekut.

Ky fletudhëzim së fundmi është miratuar në
02/2023.